



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

---

Numri i lëndës: 2019:202111

Datë: 03.03.2021

Numri i dokumentit: 01562044

**P.nr.413/2019**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të akuzuarës H. M., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4090/2020 datë 12.09.2019, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 07.12.2020 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M URDHËR NDËSHKIMOR**

E akuzuara:

**H. M.**, nga i ati V., e lindur më datë ..., me vendbanim në Podujevë, rruga “T.” nr. ..., me numër personal të identifikimit:..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

### **Ë S H T Ë F A J T O R E**

**Sepse,**

Nga data e pa caktuar e deri më datë 02.04.2019, e pandehura me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla, duke e keqpërdorur energjinë elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollës nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, është vërejtur se e pandehura ka bërë lidhje direkte nga ZBARA, në siguresë të kabllit të tij furnizues duke anashkaluar matjen e shpenzimeve të energjisë elektrike, në njehsor elektrike, ndërsa përçuesin nga dalja e njehsorit e ka hequr dhe ishte i lirë, me ç’ rast të dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm material.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 69 dhe 314 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 360, 365, 453 dhe 495 të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumën prej **100€ (njëqind/euro)**, të cilin dënim e akuzuara është e detyruar ta paguajë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 të KPRK-së, t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një (1) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

Detyrohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 Euro**, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të paguaj shumën prej **30 Euro**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara KEDS-Divizioni në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë me kërkesë për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor PP.II.nr.4090/2020 datë 12.09.2019, kundër të akuzuarës H. M., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Sipas nenit 495 dhe nenit 493 par. 1 të KPPRK-së, për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, dhe ka prova të besueshme se vërtetë e akuzuara e ka kryer veprën penale, në kërkesë të Prokurorit të Shtetit në aktakuzë, gjykata mund ta aprovoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe të akuzuarit t'ia shqiptoj dënimin e propozuar si në kërkesë.

Sipas nenit 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, për këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në 3 (tre) vite. Po ashtu, Prokurori i Shtetit, kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, i ka bashkangjitur edhe prova të besueshme, nga të cilat prova rezulton se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës dhe bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, procesverbali me numër 0711049 i datës 02.04.2019, si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, duke e aprovuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPPRK-së dhe të akuzuarit ia shqiptoj dënimin me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, prandaj ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit-urdhërit ndëshkimor, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushalle është marrë, konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga ndonjë ekspert i pavarur për vlerësimin e dëmit, andaj mbi këtë bazë është udhëzuar në konstatim civil, pasi që gjykata nuk ja fali besimin, vlerësimin e dëmit vetëm nga pala e dëmtuar për shkak se nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.413/2019, dt. 07.12.2020**

**Sekretare juridike**  
Fatmire Podvorica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Minir Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktgjykimi-Urdhri Ndëshkimor është i lejuar kundërshtimi brenda afatit prej 8 ditëve, nga dita e pranimit të njëjtit, drejtuar kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor merr formën e prerë.